



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 31.08.2022

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullës për Parashtrimin e Ankesave të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 29.08.2022, të parashtruar nga **Grupi i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë - Kontratë dy vjeçare “, **Nr. i prokurimit- 632-22-5416-5-1-1, nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Aprovohet si pjesërisht e bazuar,** kërkesa për ri-shqyrtim e Grupit të Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË e dt.29.08.2022, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë - Kontratë dy vjeçare “, **Nr. i prokurimit- 632-22-5416-5-1-1**, kundër NJOFTIMIT MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, të publikuar me datë 23.08.2022, në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Anullohet** NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AUTORITETIT KONTRAKTUES, i publikuar me datë 23.08.2022.
- 3.** Autoriteti Kontraktues, vendos që të kthejë lëndën në ri-vlerësim.
- 4.** Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së.

A r s y e t i m

Grupi i Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; PE - VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË, me dt.29.08.2022, ka parashtruar kërkesës për rishqyrtim, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i stadiumit të qytetit në Gjakovë - Kontratë dy vjeçare”, Nr. i prokurimit- 632-22-5416-5-1-1, Nr. i brendshëm-632-22-037-511.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 31.08.2022, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pas shqyrtimit të Kërkesës për rishqyrtim të Grupit të Operatorëve Ekonomik VB. TOFAJ; JOOS & KRASNIQI - BAZE SH.P.K.; PE -VLA-KU SH.P.K. DEGA NË KOSOVË., të dt.29.08.2022, Autoriteti kontraktues, konstaton se pretendimet e Grupit të Operatorëve në fjalë, janë pjesërisht të bazuara, prandaj vendos që të kthejë lëndën në ri-vlerësim.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar në ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . Ankesa pranë OSHP-se duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit të këtij vendimi.

Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit

